



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin

Nr. 29/11 Prot
Dt. 04.06.2018

VENDIM

Nr. 23 datë 30.05. 2018

“Për

Miratimin e kërkesës se subjektit “Gega - G” për marrje “Leje për përdorimin pus – shpimi “ “Ujë teknologjik”, njësia administrative Polis, bashkia Librazhd.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës se subjektit “Gega - G” për marrje “Leje për përdorimin pus – shpimi “ “Ujë teknologjik”, njësia administrative Polis, bashkia Librazhd.

Koordinatat e pusit janë :

X 45 59 507

Y 44 36 900

Z 194 m

Viti i hapjes së pusit	2016
Thellësia e pusit	6.0 m
Kapaciteti i pusit	0.2 m³ /s
Volumi maksimal i ujit që kërkohet për përdorim	0.008 m³/orë
Diametri i pusit	2000 mm
Prurja mesatare	0.01 m³/s
Prurja mesatare e muajit më të thatë	0.008 m³/s
Sasia e ujit që kërkohet për përdorim	0.008 m³/s

Koordinatat e pikës së shkarkimit :

X 45 59 635

Y 44 36 850

Z 210 m

Prurja që shkarkohet

0.008 m³/s

Volumi që shkarkohet

2.0 m³/ditë

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

PËRGJEGJËS ABU

KRYETARI I KBU

SHKUMBIN

SHKUMBIN

Dashamir BIÇAKU

Maksim MALAJ

